

## Fleta e punës për nxënësit 8.4

### Fletë planifikimi për kryetarët

#### Detyra e kryetarit të parë - kryeson debatin

Kryetari drejton debatin dhe sigurohet që debatuesit të respektojnë rregullat e debatit (shih & Fletën e punës së nxënësit 8.2) dhe të trajtojnë njëri-tjetrin në mënyrë të drejtë dhe me respekt. Kryesuesi është neutral dhe nuk priret drejt ndonjërit prej ekipeve në debat.

Në veçanti, kryetari është kontrollues i kohës. Asnjë folës nuk duhet të flasë më shumë se një minutë. Në praktikë kjo do të thotë se pasi minuta ka mbaruar, folësi duhet të përfundojë fjalinë e tij të fundit dhe më pas të ndalet. Nëse është e nevojshme, kryetari me mirësjellje, por në mënyrë të vendosur, e ndërpret folësin dhe i jep fjalën kryetarit të ekipit tjetër.

#### *Pajisje*

- Një kronometër ose orë që tregon saktësisht sekondat. Telefonat celularë mund ta kryejnë një funksion të tillë.
- Fletë shënimi dhe lapës.
- Një letër të verdhë dhe një të kuqe letre ose karton, madhësia A7.
- Shtesa & Fletët e punës së nxënësit 8.2, 8.5.

#### *Detyra e kryetarit gjatë debatit*

##### 1. Ai hap debatin:

- Përshëndet ekipet, audiencën si dhe gazetarët e lajmeve.
- Përmbledhje e shkurtër e debatit, pa ndonjë hollësi që mund të ndihmojnë një anë.
- Kujtesë për ekipet: lojë e ndershme, zbatim i rregullave.
- Shpallja e rregullave të kohë-matjes: pas 50 sekondave, kryetari jep një shenjë.
- Pas një minutë, kryetari ndalon folësin - për të siguruar lojë të ndershme.

##### 2. Gjatë debatit:

- Kryetari dëgjon debatin në heshtje.
- Kryetari monitoron kohën e të folurit dhe i jep shenjë 50-të sekondëshe.  
(Shumë shpesh, kjo është gjithëshka që bën kryetari.)
- Kryetari ndërhyt nëse folësit kalon për kohën e tyre duke folur për një minutë.
- Kryetari ndërhyt nëse debatuesit ose audienca ndërpresin folësin në ndonjë mënyrë.
- Në raste shumë të rënda të sjelljes së keqe ose të padrejtë, kryesuesi tregon kartonin e verdhë ose /dhe të kuqin ndaj një folësi. Kartoni i kuq do të thotë se një folësi duhet të lërë debatin.

##### 3. Pas debatit:

- Kryetari njofton se debati është mbyllur.
- Kryetari falënderon debatuesit dhe publikun.

### *Roli i kryetarit, pas debatit*

Pas debatit, publiku ka një diskutim të shkurtër vijues për debatin (pesë minuta) dhe pastaj voton për anën që, sipas tij, paraqiti argumentet më bindëse.

## **Detyra e dytë e kryetarit – kryesimi i votimit të publikut dhe diskutime**

### 1. Vijim diskutimi

- Kryetari njofton se publiku ka pesë minuta gjatë të cilave mund të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre për debatin. Vendet janë të riorganizuara në një rreth ose gjysmërreth të madh, për të lejuar të gjithë nxënësit që të përballen me njëri-tjetrin.
- Çdo anëtar i audiencës ka bërë shënime gjatë debatit dhe ka menduar në lidhje me pyetjen se cili grup ka debatuar më bindshëm. Kryetari kërkon një votim me duar - një votim paraprak.
- Pastaj marrin fjalën nxënësit që kanë pikëpamje të ndryshme. Kryetari u kërkon atyre të shkëmbejnë mendimet në të njëjtën mënyrë si bënë debatuesit, sepse koha është e pakët.
- Pas pesë minutave kryetari përfundon diskutimin.

### 2. Votimi

- Kryetari shpall votimin. Ai e përsërit çështjen dhe pyetjet që duhet të votohen: cili ekip ju ka bindur më shumë - pohuesi apo mohuesi? Në këtë pikë nuk ka më diskutime. Kryetari i kërkon një nxënësi të shënojë rezultatet e votimit në dërrasë apo tabelë.
- Kryetari, së pari, u kërkon nxënësve, që janë më të bindur për anën pohuese, të ngrenë duart. Ai i numëron ato dhe pastaj, në të njëjtën mënyrë, kryen votimin për anën pohuese.
- Së fundi, nxënësit që abstenojnë - të cilët nuk kanë votuar për asnjë nga ekipet - thirren dhe numërohen.
- Kryetari lexon rezultatin e votimit, por nuk komenton për të. Ai falënderon audiencën për diskutimet dhe votën e tyre dhe përfundon seancën.